

**UNITED
NATIONS**

United Nations
Interim
Administration
Mission
in Kosovo



UNMIK

NATIONS UNIES

Mission
d'Administration
Intérimaire des
Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

Legjislatura e dytë

*Komisioni për Shëndetësi, Punë
dhe Mirëqenie Sociale
Nr. 26/2007*

PROCESVERBAL

*i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, të mbajtur më
20. 9. 2007, në sallën N-10, në orën 10.30*

Të pranishëm: Fatmire Mulhaxha- Kollçaku, kryetare: Naim Jerliu, Shpresa Murati, Nafije Berisha, Ilaz Pireva, Zylfije Hundozi, Rudina Bukoshi, Flora Brovina, Fehmi Vula, Zahrije Jusufi, Ferid Agani dhe Teuta Hadri anëtarë.

Munguan : Zllatica Kujundiq .

Moren pjesë :

- 1 z. Haki Shatri ministër i Ministrisë se Ekonomisë dhe Financave ,
- 2 z. Ibrahim Selmanaj mister i Ministrisë për Punës dhe Mirëqenie Sociale .

Mbledhjen e drejtoi **Fatmire Mulhaxha – Kollçaku** dhe propozoi këtë:

REND DITE

1. Takim me Ministrin z. Haki Shatri dhe z. Ibrahim Selmanaj për vërejtjet e dhëna nga Fondi Monetar Ndërkombëtar në Projektligjin e punës.

Rendi i ditës u miratua.

U hap shqyrtimi për pikën e parë.

1 Takim me Ministrin z. Haki Shatri dhe z. Ibrahim Selmanaj për vërejtjet e dhëna nga Fondi Monetar Ndërkombëtar në Projektligjin e punës.

Fatmire Mulhaxha –Kollçaku i përshëndeti ministrat z. Haki Shatrin dhe z. Ibrahim Selmanaj dhe shtoi : Projektligjit të punës i kemi kushtuar rëndësi të madhe duke i mbajtur dy dëgjime publike dhe kemi angazhuar ekspert ndërkombëtarë të ndihmuar nga IND-a dhe ata lokalë. Me tujte ceku se Komisioni është ballafaquar me probleme lidhur me Projektligjin e punës i cili ka implikime buxhetore . Kjo na është konfirmuar nga ana e Fondit Monetar Ndërkombëtar. Me tujte nënvizoi se qëllimi ishte të informohen anëtarët e Komisionit përse afërmi nga dy ministrat dhe ftoi të marri fjalën.

Z. Haki Shatri ,minister – detyrë e MEF është të japë mendimin lidhur me projektligjet se a përmbajnë implikime buxhetore Problematikë paraqiten Ligji për vlerat e luftës ,Ligji për sigurimet shëndetësore ,Projektligji i punës dhe ai për Sigurimin Pensional pasi Qeveria nuk i ka përfshirë në kornizën afatmesme dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar , Komisioni Evropian e kanë harmonizuar kornizën e shpenzimeve për vitet 2008-2010. Në vazhdim ceku se implementohen këto ligje janë të papërbalueshme për buxhetin e Kosovës .Pra na është rekomanduar nga FMN këto projektligje të mos impletohen para vitit 2010 Ai i njoftoi se me donatorët e jashtëm do të ketë një takim ku jemi pregaditur në pritjen e tij ku do të shqyrtohet situata financiare . Ministria e Ekonomikë dhe e Financave nuk dëshiron të hyjë në ndryshimin e përmbajtjes se Projektligjit të punës ,por me këtë përmbajtje që është dhënë ,është llogaritur se do ta kapë shumën prej 23 milion euro dhe nga ky aspekt për MEF është i pazbatueshëm. Komisionit i rekomandon që të punojnë në atë dokument Sa u përket këtyre akteve Qeveria i ka ditur këto struktura financiare ,po nuk kemi dashur të ndërpresim me këto projektligje dhe e kemi lenë kur te jemi të gatshëm financiarisht të behet zbatimi i tyre Ai apeloj që mos të filloi ketë ligje të cilat kostot buxhetore do të ishin kundërshtim me rekomandimet e Komisionit Evropian dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar Ai pastaj në vija trasha foli për kornizën e shpenzimeve kapitale investimet e paraparë në lëmin e komunikacionit etj.

z. Ibrahim Selmanaj minister përshëndeti të pranishmit dhe ekspozuan e z. Shatri dhe shtoi : lidhur me Projektligjin e punës i respekton rekomandimet e dalura nga FMN që monitorojnë ,por do të pyetsha se cili do të ishte mendimi partnerëve socialë dhe ai si problem e sheh moszgjidhjen e statusit dhe mosrregullimi i dokumentacionit të punëtorëve sezonal të punësuar jashtë Kosovës. . Ministria ka nevojë t'i ketë Ligjin për sigurime shëndetësore ,Projektligjin Pensional dhe të Punës . Pra sipas tij është i domosdoshëm Projektligji i punës dhe i kërkoi Komisionit të vazhdohet me procedimin duke mos kushtëzua data .

Flora Brovina –ceku Projektligjet i takojnë fushës më të ndjeshme t[shoqërisë dhe i quajti bombë sociale . Në këtë kontest përmendi Ligji i vlerave të luftës në tersi nuk po zbatohet dhe shtroi pyetjen: lidhur me donacionet duke kërkuar nga ministri se do tu ndahet këtyre dy fushave dhe çka keni paraparë në planin strategjik.

Ajo lidhur me Projektligjet është dashtë të bisedohet në nivel të Qeverisë, nga se sipas saj pa këto ligje nuk mund të funksionoj.

Teuta Hadri duke u ndërlidhur me diskutimin e ministrave shtroi pyetje : Investimet kapitale në shëndetësi, Ministra Ekonomi dhe Financa çka është duke bërë me parat e kujdestarive dhe pse nuk respektohet memorandumi i arritur.

Fatmire Mulhaxha –pyetjen e radhitjen e prioriteteve Ministria a ishte e pavarur dhe a ka mundësi të behet zgjerimi?

Zylfije Hundozi duke u ndërlidhur me parafolësit ceku se Komisioni është i interesuar që Kuvendi i Kosovës të miratojë Projektligjin e punës . FMN dha vërejtje lidhur me implikimet buxhetore përkundër qe ky është i domosdoshëm.

Nafije Berisha –duke u ndërlidhur me diskutuesi ceku se sikur të ishte një organizim më i mirë këto dy projektligje do të kalonin. Ajo vërejtje i beri Trustit Pensional ngase ky sistem është aplikuar ne sisteme të zhvilluara .Pra është dashtë të shkohet sipas sistemit ti paguaj unë marrë (solidar) duke kërkuar mjete e trustit kush i menaxhon dhe ku ndodhen?.

Nurishahe Hulaj ,shtroi pyetje për mos pagesat e kujdestarive për gjashtëmujorin e parë të viti 2007 dhe sipas saj se për këtë qëllim janë ndarë 1.20000.00 euro dhe kërkohe të nxjerrët veçanet duke shtruar pyetje : A hyjnë në participim të hyrat vetanake në qarkoren e buxhetit apo ne dokumentin kornizë financiar dhe a hynë participimi në kodin pagave e mëditjeve .

korniza a hynë kod të veçanet apo për pagesa të kujdestarive.

Ilaz Pireva pyeti për një bashkëveprim që duhet të marrë bekimin e MEF për kundër dallimeve të mëdha .Ai ngriti çështjen e Projektligjit për Inspektoratin e punës ku ka paqartësi rreth themelimit të Agjencioni të inspektoratit të punës nga autoritet dhe a ka Ministria e Punës vijë buxhetore

Ferid Agani pyeti shtroi pyetje : Pse korniza afatmesme nuk është debatuar ne Kuvendin e Kosovës, pasi ajo paraqet dokument politik ,pastaj ngriti çështjen e Trustit Pensionale dhe kërkoj sqarim se a ka iniciativë nga Qeveria të reformohet qasja e trustit dhe t’u kthehen mjetet e deponuara punëtoveve vendorë. ,kush e ka dhënë pëlqimin për krijimin e tij. Ai u pajtua me znj .Hundozi lidhur me alternativat nëse do të zbatoni 30% të ligjeve do të permisionin gjendjen e dhe vërejtje mungesën e bashkëpunimit .

Ministri Shatri iu përgjigj pyetjeve të deputeteve që të pranishmit u mirëpritën .

Naim Jerliu nënvizoi se po ballafaqohemi me një situatë paradoksale lidhur me implementimin e këtij Projektligji Gjithashtu ,kemi një qëndrim të Fondit Monetar Ndërkombëtar ku jepen vërejtje për koston buxhetore dhe se nuk duhet të miratojmë ligje të cilat pas 3 vite do të implementohen dhe se këtë mendim Komisioni e ndan me ministrin në krijimin e mundësive të implementimit të tij. Tani jemi në situatë të palakmueshme për të ndryshuar Projektligjin qe përmban shumë implikime qe lidhet me ekspertizën dhe është jashtë kapacitetit të Komisionit. Ai i propozoi t’i dorëzohet Qeverisë dhe të marrë në rishqyrtim të punojë ne krijimin e mundësive qe të na sjellë një propozim të ligjit me ato elemente qe konsiderohen që do të ishin të implementueshme .para afatit tri vite .

Pastaj deputetë Flora Brovina ;Ferid Agani ,Naim Jerliu ;Teuta Hadri ,Fehmi Vula dhe Nurishahe Hulaj kontribuon në kërkimin e një zgjedhje dhe u pajtuam me propozimin e parafolësit.

Komisioni vendosi ne mbledhjen e radhës të merret për mënyrën e procedimit të tij

Z Ibrahim Selmanaj u zotua qe deputetit Ilaz Pireves t’i përgjigjet ne pyetjen e shtruar me shkrim .

Pasi anëtarët ishin të lodhur nuk i shqyrtuan piken e dytë dhe të tretë të rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi në orën 13,40.

Procesmbajtës,

Rrahim Demaj – zyrtar i lartë ligjor

**Kryetarja e Komisionit
Fatmire Mulhaxha- Kollçaku**